



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
QENDRA KOMUNITARE MULTIDISCIPLINARE

Nr ___ Prot

Tiranë, më 17.04.2026

SHTOJCË NR. 1 Datë 17.04.2026

PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTEVE TË TENDERIT

Procedura me REF-80960-04-03-2026

Objekti: “Pako Ushqimore”

Autoriteti Kontraktor: Qendra Komunitare Multidisiplinare

Në mbështetje të nenit 75 të Ligji nr. 162/2020 për prokurimin publik dhe nenit 78 të VKM nr. 285/2021 për rregullat e prokurimit publik, si dhe në vijim të sugjerimeve të dhëna nga asistenca e Agjencise Prokurimit Publik (APP), Autoriteti Kontraktor bën këto ndryshime dhe saktësime në Dokumentet e Tenderit:

1. Plotësimi i argumentimit të specifikimeve teknike

Në dokumentet e tenderit dhe në procesverbalin përkatës është **shtuar dhe plotësuar argumentimi i specifikimeve teknike**, duke u bazuar në:

- nevojat konkrete të institucionit për furnizimin me produkte ushqimore për të mbështetur familjet ekstremisht të varfra, grupe viktima të dhunës dhe familjet me femije nën 18 vjeç të cilat kanë probleme socio-ekonomike.

Ky argumentim është hartuar në përputhje me nenin 36 të LPP dhe nenin 40 të VKM nr. 285/2021.

2. Ndryshim në kriteret e kapacitetit ekonomik dhe financiar

Hiqet kriteri:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve ndaj Ujësjetës Kanalizime.”

Ky ndryshim bëhet në zbatim të parimit të mosdiskriminimit dhe garantimit të konkurrencës, në përputhje me nenin 3 të LPP dhe nenin 40 të VKM nr. 285/2021.

3. Saktësim i kriterit për përvojën e mëparshme

Në pikën përkatëse të kapacitetit teknik, termi:

“shërbime të mëparshme”

zëvendësohet me:

“furnizime të mëparshme të ngjashme”

Gjithashtu, kriteri është riformuluar në përputhje me natyrën e kontratës (mallra), si dhe me përcaktimet e nenit 40 të VKM nr. 285/2021.

4. Përditësimi i referencave ligjore

Janë rishikuar dhe përditësuar referencat ligjore në dokumentet e tenderit, duke eliminuar aktet e shfuqizuara dhe duke u bazuar vetëm në legjislacionin në fuqi.

6. Shtyrja e afatit të dorëzimit të ofertave

Me qëllim garantimin e transparencës dhe dhënien e kohës së nevojshme për operatorët ekonomikë për t'u njohur me ndryshimet e bëra, si dhe në mbështetje të nenit 75, paragrafi i tretë i pikës 2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave shtyhet me 7 ditë, deri më datë 24 / 04 / 2026.

7. Dispozita të fundit

Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë pjesë përbërëse e Dokumenteve të Tenderit dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Dokumentet e rishikuara publikohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

